

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"CONTRACT FURNITURE" SH.P.K.**

Sot më datë 07/07/2017 (dymijë e shtatëmbëdhjetë), ortaku themelues :

- **Flori Stojku i** lindur më 27/06/1991 në Fier (FR), Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.027160310, me adresë: Lagja 11 Janari Fier, Shqipëri, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

Vendosi themelimin e shoqërise "Contract Furniture" shpk përmes këtij akt themelimi për themelimin e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar ("**Shoqëria**") në pajtim të plotë me ligjet e Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("**Ligji për Shoqëritë Tregtare**") dhe me statutin e saj.

**EMRI I SHOQËRISË, SELIA ZYRTARE, PERSONALITETI JURIDIK DHE  
KOHËZGJATJA**

**Neni 1  
Emri i shoqërisë**

Emri i Shoqërisë është: "**Contract Furniture**" shpk.

Në të gjitha dokumentet, faturat, reklamat dhe publikimet e lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht mjeteve të transmetimit, emri i Shoqërisë duhet të paraprihet ose të ndiqet nga të mëposhtmet:

- a. fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "Sh.p.k.",
- b. numri i saj unik i identifikimit (NIPT),
- c. selia e saj zyrtare,
- d. të dhënat nëse Shoqëria është në likuidim.

**Neni 2  
Forma e personalitetit juridik**

Shoqëria është krijuar si një entitet juridik shqiptar me formën juridike të një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (*shoqëri me përgjegjësi të kufizuar*) siç parashikohet në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.



**Neni 3**  
**Selia zyrtare, zyrat qendrore**

Selia zyrtare e Shoqërisë është : Lagja 11 Janari, Rruga Ramiz Aranitasi, Njësia nr.4, Godina nr.2 Fier, Shqipëri.

Shoqëria mund ta zhvendosë selinë ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Shqipëri.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja e shoqërisë**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar.

**OBJEKTI I SHOQËRISË**  
**Neni 5**  
**Objekti i shoqërisë**

Ne fushen e tregtimit me shumice e me pakice, import-eksport i mallrave industriale te llojeve te ndryshme, artikujve elektro-shtepiake, pjese nderrimi per makineri te llojeve te ndryshme, te metaleve te çdo lloji, te artikujve ushqimore, bujqesore e blegtorale, bime medicinale, pije alkoolike e eterovajore, makineri e pajisje te ndryshme, vajra lubrifikante e karburante, pjese hidraulike, higjeno-sanitare, pajisje elektrike, te kozmetikikes, bizhuteri, te materialeve te ndertimit, te artikujve te mobilerise se drurit te perpunuar, pajisje e makineri per perpunimin e drurit, pika prodhimi te mobilerise, kozmetikikes, pika servisi per automjete, sherbime hotelerie, transport mallrash dhe udhetaresh, veprimtari private ne fushen e ndertimit, projektimit dhe zbatimit. Transport ndërkombetar mallrash për të tretë e me qera.

Sherbime konsulence, promovimi, promocioni, reklamimi, ne fushen e mobilerise, ne fushen financiare dhe juridike dhe cdo sherbim tjetër brenda dhe jashtë vendit

Veç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që rezulton ose që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me objektivin e mësipërm.

**KAPITALI FILLESTAR DHE ORGANIZIMI**

**Neni 6**  
**Kapitali fillestar**

Kapitali i fillestar i regjistruar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë.

Kapitali fillestar i regjistruar perfaqësohet nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, të cilat do të ngurtësohen në Bankë mbasi shoqëria të regjistrohet ne QKB.



## **Neni 7** **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administratorët – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Organizimi dhe funksionimi i këtyre organeve është përcaktuar në statutin e shoqërisë. Shoqëria administrohet nga administratori i cili zgjidhet për një mandat 5 vjecar me te drejte rizgjedhjeje. Administratori i shoqërisë do të jetë:

- **Flori Stojku** i lindur më 27/06/1991 në Fier (FR), Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit ID nr.027160310, me adresë: Lagja 11 Janari Fier, Shqipëri. Shoqëria përfaqësohet para cdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe ne marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili do iu ushtrojë këto të drejta në përputhje me statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Data: 7 korrik 2017

**ORTAKU THEMELUES:**

**Flori Stojku**

